



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I MINISTRAVE**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 1, datë 02.02.2018

**PËR**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,**  
**BASHKIA MAT**

Në mbështetje të neneve 7, 20 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozimin e Bashkisë Mat, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 65 datë 30.11.2017, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mat, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
  - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali hartografik:
    - i. Vizioni strategjik;
    - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
    - iii. Ndarja e territorit në njësi;
    - iv. Përdorimi i propozuar i tokës;
    - v. Infrastruktura e transportit;
    - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
2. Në Zonat e Rëndësisë Kombëtare brenda territorit administrativ të Bashkisë Mat, shpallur si të tilla nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit apo me vendime të veçanta, autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara është Këshilli Kombëtar i Territorit.



3. Në Zonat e përcaktuara si të Rëndësisë Kombëtare dhe për Objektet e Rëndësisë Kombëtare, përfshirë edhe ato që ngrihen në pronat shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore, autoriteti përgjegjës për miratimin e Lejeve të Zhvillimit dhe Ndërtimit, është Këshilli Kombëtar i Territorit.
4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Mat duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Mat për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen studimet urbanistike/dokumentet e planifikimit të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Mat.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETAR I TERRITORIT  
KESHILLI I MINISTREVE

**DAMIAN GJIKNURI**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

**LEDIA TOTA**

